



UNIVERSITETI I SHKODRËS

“LUIGJ GURAKUQI”

RREGULLORE

"PER ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE NE KESHILLIN STUDENTOR,
UNIVERSITETI I SHKODRES 'LUIGJ GURAKUQI'"

Shkodër, 2018



DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton rregulla për përgatitjen, organizimin, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve në Këshillin Studentor, të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" duke përfshirë:

Kushtet dhe afatet për regjistrimin e kandidatëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre, dokumentacionin zgjedhor, listat e zgjedhësve, fushatat zgjedhore;

Rregullat për organizimin dhe funksionimin e administratës zgjedhore;

Kriteret për hartimin e listës së zgjedhësve;

Procedurat për votimin, vlerësimin dhe numërimin e votave, shpalljen e rezultateve;

Procedurat për shqyrtimin e animimeve;

Administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit.

Neni 2


Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në ligjin nr. 80, datë 22.07. 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartën në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" dhe Statutin e Këshillit Studentor të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi",

Neni 3

Subjekt i rregullores

1. Subjekt i kësaj rregulloreje janë Këshilli Studentor të njësive kryesore në Universitetin e Shkodrës dhe Këshilli Studentor i Universitetit të Shkodrës.
2. Çdo student me kohë të plotë, në Universitetin e Shkodrës, i cilësuar i tillë sipas Rregulloreve të Studimeve të USH-së, ka të drejtën e tij të zgjedhjes dhe të të zgjedhurit, në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë rregullore.



Neni 4

Parimet e përgjithshme

1. Zgjedhjet për Këshillin Studentor të njësive kryesore në Universitetin e Shkodrës dhe ato të institucionit, janë periodike, zhvillohen çdo 2 vjet.
2. Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë rregullore. Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e votës.
3. Çdo zgjedhës ka të drejtën e një vote të vetme për kandidatët në këshillin studentor të njësive kryesore dhe këshillin studentor të institucionit.
4. Të drejtën për t'u zgjedhur si anëtar në këshillin studentor të njësive kryesore dhe këshillin studentor të institucionit, e ka çdo student me kohë të plotë, në universitetin e Shkodrës, në të gjitha ciklet e studimeve dhe që ka një mesatare mbi 7.00.
5. Një kandidat mund të konkurrojë vetëm për një vend në këshillin studentor të fakultetit përkatës ose në këshillin studentor të institucionit.
6. Çdo kandidat ka të drejtën të organizojë dhe zhvillojë aktivitete për paraqitjen e programit të tij, duke mos cenuar procesin mësimor.
7. Shpallet i zgjedhur në postin e anëtarit të këshillit studentor të njësive kryesore dhe këshillin studentor të institucionit kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që marrin pjesë në votim, me përjashtim të kandidatëve të vetëm.
8. Kur kandidon një kandidat i vetëm, ky i fundit shpallet fitues me jo më pak se 50 përqind plus një të votave të vlefshme. Nëse kandidatët nuk arrijnë të fitojnë një numër të tillë votash, 10 ditë pas ditës së zgjedhjeve zhvillohet një raund i dytë, pas të cilit nëse kandidati i vetëm nuk fiton 50 përqind plus një të votave të vlefshme, shpallen zgjedhje të reja.
9. Në rast se për vendin e anëtarit të këshillit studentor nuk regjistrohet ose nuk fiton asnjë kandidat, zgjedhjet për këtë vend zhvillohen, me urdhër të Rektorit, jo më përpara se 3 muaj nga data e zgjedhjeve të shpallura. Zgjedhjet e përsëritura zhvillohen në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.
10. Zgjedhje të përsëritura zhvillohen jo më vonë 6 muaj përpara përfundimit të periudhës 2-vjeçare pas zgjedhjeve të fundit.
11. Kur mandati i anëtarit të zgjedhur përfundon para afatit të përcaktuar, vendin e tij e zë student i listuar menjëherë pas tij.

Neni 5

Periudha zgjedhore dhe thirrja e zgjedhjeve

Zgjedhjet për anëtarë të Këshillave Studentore zhvillohen në mënyrë periodike, çdo dy vjet.

Dita e fillimit të procesit zgjedhor dhe dita e zgjedhjeve caktohet dhe shpallet nga Rektori i Universitetit të Shkodrës.

Qendrat e votimit hapen në orën 8.00 dhe mbyllen në orën 15.00. Askush nuk mund të votojë pasi KZF (KQV) merr vendim për mbylljen e votimit.

Neni 6

Organet për përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve

Komisionet e zgjedhjeve në Fakultet (KZF) përkatëse përbëhen nga dy studentë dhe dekani i studenteve në atë fakultet.

Komisioni i zgjedhjeve në institucion (KIZ) përbëhet nga tre student, dekani i studenteve në rang institucioni dhe një pedagog i caktuar nga rektori.

Komisioni i Apelit përbëhet nga dy studentë dhe një jurist.

Anëtarët e komisioneve nuk kanë të drejtë të kandidojnë për të qenë pjesë në këshillin studentor të njësive kryesore ose këshillin studentor të institucionit.

Anëtarët studentë vetprovozohen për të qenë pjesë e këtyre komisioneve.


Neni 7

Fushata elektorale

Fillimi i fushatës përcaktohet nga Rektori i USH-së, dhe zgjat dy javë nga data e mbajtjes së zgjedhjeve.

Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin idetë, opinionet dhe qëndrimet e tyre përballë komunitetit studentor nëpërmjet përdorimit të mjediseve të fakulteteve jashtë kohës së përdorimit akademik si dhe mediat e shkruara dhe elektronike. Për këtë arsye ata inkurajohen të organizojnë edhe forume të përbashkëta me kandidatët për të shprehur opinionin e tyre përballë komunitetit studentor.

Administratori i USH në bashkëpunim me dekanët e fakulteteve krijojnë kushtet për një fushatë të rregullt elektorale të studentëve.



Neni 8

Regjistrimi i kandidatëve

Regjistrimi i studentëve kandidatë bëhet pranë KIZ sipas përcaktimeve publike

Lista përfundimtare e studentëve që kandidojnë afishohet në mjediset publike të fakulteteve dhe universitetit si dhe në faqen web të USH.

Studentët kandidatë kanë të drejtë të shfrytëzojnë mjediset e fakulteteve për realizimin e fushatave të tyre elektorale.

Listat e votuesve përgatiten bazuar në regjistrat e grupeve mësimore, në të cilat përfshihen të gjithë studentët e fakulteteve (sistemi me kohë të plotë).

Neni 9

Procesi i votimit

Procesi i votimit në fakultet dhe në institucion organizohet brenda një dite, i përqendruar në një mjedis publik të fakultetit dhe me një kuti votimi të vetme,


Çdo student pajiset me dy fletë votimi standarde një për anëtar për këshillin studentor të fakultetit të tij dhe një për anëtarë në Këshillin Studentor Institucional dhe në të shënon vetëm përkrah emrit të një kandidati.

Fletët e votimit duhet të përmbajnë emrat e të gjithë studentëve kandidatë, të të njëjtit fakultet.

KZ duhet të ndjekin mënyrën korrekte të hedhjes së fletëvotimeve në kutinë e votimit dhe duhet të numërojnë votat e mbledhura (duke i verifikuar që të jenë të barabarta me ato të dhëna) sapo të mbarojë procesi i votimit.

Çdo student duhet të marrë pjesë në votim me kartën e identitetit (pasaportën) dhe të vendosë firmën në listën e votuesve kundrejt marrjes në dispozicion të fletëve të votimit.

Procesi i votimit nis në orën e përcaktuar nga kjo rregullore dhe përfundon kur nuk ka më studentë që duan të votojnë. Në çdo rast procesi i votimit nuk mund të mbyllet para orës së përcaktuar nga kjo rregullore.



Neni 10

Mbyllja dhe procesi i numërimit

Menjëherë pas mbylljes së procesit të votimit numërohen votat në mënyrë të hapur.

Kandidatët fakulteteve përkatëse që kanë marrë shumicën e thjeshtë të votave shpallen anëtare të këshillit studentore. Gjithkush ka të drejtë të vëzhgojë procesin e numërimit të votave.

Neni 11

Rezultati i zgjedhjeve

Rezultati i zgjedhjeve shpallet publikisht në mjediset e fakulteteve menjëherë pasi janë numëruar fletët e votimit dhe është nënshkruar procesverbali nga komisionet e zgjedhjeve në secilin fakultet.

Procesverbali së bashku me materialet zgjedhore depozitohet në KZI, ndërsa secili nga anëtarët ka të drejtë të marrë nga një kopje të procesverbalit.

Komisioni i zgjedhjeve të institucionit brenda 5 pas shqyrtimit të ankesave nga KA shpall rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për këshillat studentore të fakulteteve dhe të Këshillit studentor institucional.

Komisioni institucional i zgjedhjeve brenda 5 ditëve pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, mbledh anëtarët e zgjedhur të këshillave studentore të fakulteteve dhe të institucionit, të cilët me shumicë të thjeshtë votash zgjedhin mes tyre kryetarët respektive të këshillave studentore.

Neni 12

Ankimimet

Çdo kandidat pjesëmarrës në zgjedhjet për këshillin studentor të fakultetit ose në këshillin studentor të Universitetit ka të drejtë të bëjë ankim brenda 3 ditëve kalendarike pas shpalljes së rezultatit tek Komisioni i Apelit për vendimet e KIZ. Komisioni i Apelit shprehet brenda 3 ditëve për ankesat, vendimi i Komisionit të Apelit është i formës së prerë.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë